REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT / TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKI
Nr/Br. 662/22
Data/Datum. 05. 01. 2023
PRISHTINË - PRIŠTINA

Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT
TELO ZA RAZMATRANJE NABAVKE
PROCUREMENT REVIEW BODY

Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP) Rruga "MIGJENI" (ish-Banka e Ljubljanës) Kati V-të, Prishtinë, Kosovë
Tel:+ 383 38 212 309 e-mail: oshp@rks-gov.net

PSH. nr. 662/22

Paneli Shqyrtues, i emëruar nga Kryetarja e Organit Shqyrtues të Prokurimit Publik (OSHP), në bazë të nenit 105,106 dhe 117 të Ligjit për Prokurim Publik të Kosovës (Ligji Nr. 04/L-042, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin 04/L-237, Ligjin 05/ L-068, dhe Ligjin 05/ L-092), në përbërje nga Vedat Poterqoi -Kryetar, Agon Ramadani Anëtar dhe Kimete Gashi- Anëtare, duke vendosur sipas ankesës së parashtruar nga Operatori Ekonomik (OE) N.P.SH. "ESG" me seli në Prishtinë, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese" me nr. të prokurimit 203-22-7378-2-1-1,iniciuar- (AK)– Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues (AK), me datën 30.12.2022, mori këtë:

V E N D I M

1. Refuzohet si e pabazuar ankesa e operatorit ekonomik, N.P.SH. "ESG" me seli në Prishtinë, e parashtruar në Organin Shqyrtues të Prokurimit me 15.11.2022 (me numër protokolli 662/2022) për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese" me nr. të prokurimit 203-22-7378-2-1-1,iniciuar- (AK)– Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në cilësinë e Autoritetit Kontraktues

2. Mbetet në fuqi, vendimi i Autoritetit Kontraktues B58 për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese".

3. Konfiskohen mjetet e deponuara në emër të tarifës ankimore dhe të njëjtat kalojnë në Buxhetin e Republikës së Kosovës, konform nenit 31 paragrafi 5 të Rregullores së Punës të Organit Shqyrtues të Prokurimit.

A r s y e t i m

- Faktet dhe rrethanat procedurale -

Me 22.10.2022, Komuna Suharekë në cilësinë e Autoritetit Kontraktues ka publikuar Njoftimin mbi Vendimin e Autoritetit Kontraktues B58 (Letër Standarde)për dhënie të kontratës për aktivitetin e prokurimit me titull: "Zhvillimi i Zonave Rurale përmes Avancimit te Shërbimeve Këshilluese" me nr. të prokurimit 203-22-7378-2-1-1, ku është shpërblyer me kontratë (GOE) OJQ KDC Gj GLV Gjeravica me seli në Gjakovë.

Me datën 15.11.2022 Operatori ekonomik "N.P.SH. "ESG" ka parashtruar ankesë në OSHP-ë, me numër të protokollit 662/2022, kundër njoftimit për anulim të aktivitetit të prokurimit të përshkruar si më sipër.

Ankesa e OE është ushtruar në pajtim me nenin 109.1, të LPP, sipas të cilit kundër çdo vendimi të marrë nga AK çdo palë e interesuar mund të parashtrojë ankesë pranë OSHP. Meqë OE ka ushtruar po ashtu kërkesë për rishqyrtim, do të thotë se veprimet e të njëjtit i referohen po ashtu dhe nenit 108/A të Ligjit të cituar. Prandaj OSHP konsideron se Ankesa i plotëson kushtet e parapara në kuptim të dispozitave tani më të cituara dhe e njëjta bie nën kompetencat e tij në kuptim të nenit 105, të LPP.

- Vlerësimi dhe administrimi i provave –

Bazuar në veprimet e përshkruara si më sipër, OSHP ka angazhuar ekspertin vlerësues në pajtim me nenin 111, paragrafi 5 të LPP, me detyrë që i njëjti në kuptim të nenit 113 të Ligjit të cituar, ta bëjë shqyrtimin fillestar të dosjes dhe pretendimeve ankimore, përkitazi me aktivitetin e prokurimit të përshkruar si më sipër. Lidhur me ketë, me 12.12.2022, eksperti shqyrtues ka dorëzuar Raportin e vlerësimit me rekomandimet si në vijim:

- Ankesa e OE të aprovohet si pjesërisht e bazuar;
- Vendimi i atakuar i AK për dhënie të kontratës, të anulohet ndërsa lënda të kthehet në ri-vlerësim.

<u>Pretendimi ankimor 1.</u>
Përshtatshmëria profesionale
l. Certifikatë e regjistrimit të biznesit, regjistrimi si operator ekonomik në regjistrin profesional, komercial dhe ose të korporatës në vendi e juaj të themelimit ose (ARBK).
Në baze të analizës se këtij te këtij pretendimi ankimor vërehet se Autoriteti Kontraktues ka bërë zbatim të gabuar të se drejtës materiale. konkretisht Ligjit për Prokurimin Publik Nr. 04/L-042 dhe Ligjit për Lirinë e Asocimit Nr.04/L-057.
Legjitimiteti i OJQ-së për tu kualifikuar si operator ekonomik

Fillimisht duhet cekur së jo çdo OJQ është organizatë e shoqërisë civile. Mungon analizimi i kësaj pjese nga autoriteti kontraktues, sepse nuk është sqaruar dhe argumentuar se OJQ ne fjalë hyn në kuadër të përkufizimit lë përcaktuar ne ligjin për prokurimin publik. Duhet analizuar statuti dhe certifikata e regjistrimit te OJQ-së në fjalë, për te kuptuar nëse c njëjta ka mandat të një organizate te shoqërisë civile.
Autoriteti Kontraktues nuk mund ta autorizoje një OJQ qe te kryej veprimtari afariste dhe fitimprurëse, pa marr paraprakisht parasysh specifikat dhe fushëveprimin e nejç organizate të tillë.
Certifikata e regjistrimit të OJQ-së
OJQ-ja në fjale ka deponuar një certifikatë regjistrimi të lëshuar nga UNMIK-u edhe përkundër faktit se tashme Republika Kosovës ka institucionet c saja për lëshimin e certifikatave të regjistrimit OJQ-ja ka qenë e obliguar
Raporti i ekspertit shqyrtues, lidhur me ankesën e parashtruar nga N.P.SH/'ESG" - Prishtinë, lidhur me aktivitetin c prokurimit "Zhvillmini i Zonave Rurale përmes Avancimit të Shërbimeve Këshilluese'' me nr. të prokurimit: 203-22-7378-2-1-1 dhe nr. te brendshëm: 203-22-10-211, të iniciuar nga Autoriteti Kontraktues (AK) - Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural që ta ndryshoje certifikatën e regjistrimit në mënyrë që ajo të jetë në pajtim me legjislacion në fuqi.
Nuk mund të konsiderohet valide një certifikatë e cila është lëshuar nga një administratë e përkohshme siç ka qenë UMNMIK-ut dhe se një certifikatë e tillë është dashtë te përditësohet dhe t'i përmbaj te gjitha elementet c një dokumenti zyrtar të cilën e lëshojnë institucionet e Republikës së Kosovës. duke filluar nga autoriteti kompetentë, logoja dhe elementet tjera konstituive të një dokumenti zyrtar.
Sipas Ligjit për Qasje në Dokumentet Publik Nr. Nr. 03/L-215, konkretisht neni 3 pika 1.3 përcaktohet se dokumentet zyrtare janë ato dokumente të lëshuara nga institucionet publike. Institucione Publike janë vetëm ato të cilat janë themeluar nga Republika c Kosovës dhe veprojnë në bazë të kushtetues së Republikës se Kosovës dhe ligjeve në fuqi. Duke u bazuar në këtë fakt një dokument i lëshuar nga UNMIK-u nuk mund të konsiderohet valide dhe si i tillë nuk mund të merret si baze për vendimmarrje, për faktin së që nga shpallja c pavarësisë se Kosovës dhe themelimi i institucioneve vendore dokumentet duhet të lëshohen vetëm nga institucionet vendore.
Krahas sqarimeve të elaboruara më lart operatorit ekonomik ankues me dt. 08.11.2022 me një pyetje i është drejtuar ministrisë përkatëse , me pyetjen si ne vazhdim:
Ky pretendim ankimor merret si i bazuar

Pretendimi ankimor II neni 69 Aftësia Teknike dhe ose profesionale
Ne bazë te analizës së këtij pretendimi nga ana e eksperti dhe kritere-ve të parapara ne dosjen e tenderit dhe ne njoftimin për kontratë ku konkretisht thuhet se:
Kapaciteti teknik dhe profesional "*Operatori ekonomik duhet te këtë staf të mjaftueshëm për zbatimin c projektit ku përveç ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhinier te diplomuar me këto profile 1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtorale 3. Ekspertë i pemëtarisë-vreshtarisë.*"

Dëshmi te dokumentuara: "*Dëshmi Kontratë pune valide ose marrëveshje për ketë projekt, Diploma e Fakultetit të Bujqësisë 4 vjeçar ose ekuivalent me master, CV, letër rekomandime ose referenca për punën c mëparshme-kopje*".
Sipas analizës se bërë nga eksperti shqyrtues i lendes operatori ekonomik i rekomanduar nga ana c autoritetit kontraktues si i suksesshëm, ka dështuar të ofroj dëshmi të mjaftueshme lidhur me Ekspertin e Prodhimtarisë Blegtorale (Eksperti posedon diplomë inxhinier i diplomuar në fakultetin e bujqësisë, mirëpo i mungon profili në lëmin e blegtorisë), ndërsa ka plotësuar kërkesat e ekspertit të Pemëtarisë e Vreshtarisë dhe kërkesën për ekspert të prodhimtarisë bimore.
Ky pretendim ankimor konsiderohet pjesërisht si i bazuar

Mendimi i ekspertit shqyrtues

Duke u bazuar në sqarimet e lartpërmendura, eksperti shqyrtues propozon panelit shqyrtues:
Ankesa e OE ankues të aprovohet pjesërisht si e BAZUAR, të anulohet njoftimi mbi vendimin e Autoritetit Kontraktues dhe lënda të kthehet në rivlerësim.

Konform nenit 24 par.1 të Rregullores së punës së OSHP-së nr.01./2020 Paneli Shqyrtues ka vlerësuar se në shkresat e kësaj lënde ka argumente dhe prova të mjaftueshme që vendimi meritor të merret edhe pa dëgjimin e palëve në seancë.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, raportit të vlerësimit të komisionit vlerësues të AK-së, shqyrtim të pikave pretenduese të parashtruara në ankesë, analizë konkrete, prezantimin e te dhënave nga eksperti shqyrtues të cekur në raport, diskutimeve dhe shoshitjeve të provave në tersi konstaton se OJQ e rekomanduar për kontratë është organizatë e shoqërisë civile dhe konform nenit 4, paragrafit 1.19 të LPP-së: "*Operator ekonomik - term i përgjithshëm që përfshinë furnizuesin, ofruesin e shërbimeve dhe/ose kontraktuesin e punëve. Për qëllim të këtij ligji, edhe organizatat e shoqërisë civile konsiderohen operator ekonomik*". Andaj, pretendimi ankimor është i pabazuar.

Paneli Shqyrtues, konstaton se OJQ e propozuar për kontratë ka prezantuar një certifikatë të lëshuar nga UNMIKU, dhe në bazë të verifikimit në linkun tek sistemi elektronik i organizatave joqeveritare kjo OJQ është e regjistruar dhe është funksionale.

Lidhur me pretendimin ankimor të parashtruesit të ankesës se i propozuari për kontratë nuk ka plotësuar kërkesën e AK-së, tek kapacitetin teknik dhe ose profesional. Paneli Shqyrtues konstaton që në nenin 9.1 të FDT-së është kërkuar: "*Operatori ekonomik duhet te kete staf të mjaftueshem për zbatimin e projektit ku përveq ekspertëve që do të angazhohen gjatë zbatimit të projektit duhet te ketë tre (3) ekspertë për Agronomi-inxhiner te diplomuar me keto profile 1. Ekspertë i prodhimtarisë bimore 2. Ekspertë i prodhimtarisë blegtoriale 3. Ekspertë i pemëtarisë-vreshtarisë*". Ndërsa, si dëshmi "*Dëshmi Kontratë pune valide ose marrëveshje për ketë projekt,*

Diploma e fakultetit te Bujqësisë 4 vjeçar ose ekuivalent me mastër, CV, letër rekomandime ose referenca për punën e mëparshme-kopje" Andaj, Paneli Shqyrtues duke u bazuar në dokumentacionin e tenderit të ofruara nga i propozuari për kontratë, vjen në përfundim se i rekomanduari për kontratë ka arritur të dëshmoj se e ka plotësuar këtë kërkesë.

Po ashtu, PSH e mbështet arsyetimin e dhënë lidhur me këto pretendime në vendimin e AK-së mbi refuzimin e kërkesës për ri-shqyrtim.

Duke vepruar mbi bazën e parimeve themelore të procedurave për shqyrtimin e prokurimit, të cilat mes tjerash, janë sanksionuar në mënyre të veçantë me dispozitën e nenit 104, të LPP dhe njëherësh duke i analizuar shkresat e kësaj lënde në relacion me faktet dhe rrethanat e përshkruara si më sipër dhe rrjedhën e procedurës, Paneli konstatoi se pretendimet kryesore mbi bazën e të cilave është ushtruar ankesa, i referohen në fakt nenit 41 (Njoftimi mbi Dhënien e Kontratës) të LPP, sipas të cilit autoriteti kontraktues ka dhënë përfundimisht një kontratë publike duke përdorur procedurat e hapura dhe duke i ndërmarrë një serë veprimesh të cilat parashihen shprehimisht me LPP, pa nevojë që të njëjtat të përshkruhen në ketë rast. Paneli konsideron se tani në ketë fazë të përmbylljes së aktivitetit të prokurimit, pretendimet ankimore janë jo relevante, përderisa i njëjti nuk ka arritur ta dëshmoj statusin e një OE të përgjegjshëm sikurse kërkohet me nenin 60 (Kriteret për Dhënien e Kontratës) të LPP. Në kontekstin e kësaj dispozite, Paneli detyrohet ta marrë në konsideratë faktin parimore se, tenderi I ofruar nga OE i cili është rekomanduar për kontratë është për 28,310.00 €, më i lirë, e që ky fakt nuk ka mundur të mohohej as nga AK. Përveç kësaj AK duhet ti ketë parasysh edhe dispozitat e neneve 1, 6 dhe 7, përmbajtja e të cilave përbën fakt notor për të gjitha AK dhe OE.

- Përfundim -

Bazuar në të lartcekurat, Paneli shqyrtues konsideron se AK nuk ka vepruar në kundërshtim me dispozitat e nenit 7, 59, 60 të LPP, të cituara në Ankesë, meqë e ka hartuar dosjen e tenderit në pajtim me kërkesat e domosdoshme, të parashikuara shprehimisht me dispozitën e nenit 27 (Dosja e Tenderit) të Ligjit të cituar kurse kriteret e aplikuar dhe veprimet e ndërmarra nuk karakterizohen me natyrë diskriminuese. Paneli Shqyrtues konsideron se veprimet dhe aktet e AK, dhe vlerësimet e ekspertit shqyrtues lidhur plotësimin ose jo të kushteve të përshkruara si më sipër dhe pohimet ankimore në ketë rast nuk përbejnë bazë të mjaftueshme që aktivitetit i prokurimit të kthehet sërish në ri-vlerësim sepse, kjo bije ndesh me fushëveprimin e LPP dhe bazën argumentuese të pretendimeve ankimore, të cilat Paneli i vlerëson sipas vlerësimit të pavarur të tij në kuptim të nenit 104 lidhur me nenin 105 të LPP. Kthimi i një aktivitetit të prokurimit pa bazë kontestuese ligjore ri-vlerësim, nuk është në harmoni me nenin 1, të LPP, sipas të cilit, qëllimi i këtij Ligji është mes tjerash, cituar: "...të siguroj integritetin dhe përgjegjësinë e zyrtarëve publik, nëpunësve civil dhe personave të tjerë që kryejnë ose janë të përfshirë në një aktivitet të prokurimit duke kërkuar që, vendimet e individëve të tillë dhe baza ligjore e faktike për vendimet e tilla, të mos

ndikohen nga interesat personale, të karakterizohet me jo-diskriminim dhe me një shkallë të lart të transparencës dhe, të jenë në përputhje me kërkesat procedurale dhe qenësore të këtij ligji".

Lidhur me nenin 105, duke e pasur parasysh kërkesën e nenit 104, paragrafi 1, të Ligjit të cituar sipas të cilit, cituar: "Procedura e shqyrtimit të prokurimit do të zbatohet dhe realizohet në mënyrë të shpejtë, të drejtë dhe pa diskriminim, që ka për qëllim zgjidhjen e drejtë, të ligjshme dhe efektive të lëndës..." Prandaj Paneli Shqyrtues i bazoi konstatimet e tij në dispozitat relevante të LPP, të cilat parashohin dhe rregullojnë situata të tilla, e që mund të paraqiten gjatë një aktiviteti të prokurimit.

Në ndajshtesë të lartcekurave, Paneli Shqyrtues thekson se secili autoritet kontraktues (në nivelin qendror dhe lokal) gëzon autonomi në planifikimin e prokurimit (neni 8) dhe në përcaktimin e nevojave që duhen përmbushur (neni 9), natyrisht ne pajtim me kapacitetin buxhetor dhe se AK në rastin konkret ka pasur të drejtë të vendos po ashtu edhe për OE të rekomanduar për dhënie të kontratës.

Paneli Shqyrtues, pas shqyrtim të gjitha fakteve dhe argumenteve ka ardhur në përfundim se AK gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti të prokurimit ka respektuar nenin 59, dhe 60 të LPP-së.

Paneli shqyrtues ne pajtim me nenin 117 të LPP-së vendosi si në dispozitv të këtij vendimi.

Kryetari i Panelit Shqyrtues
Vedat POTERQOI

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij vendimi nuk është e lejuar ankesa, por pala e pakënaqur me kërkesëpadi mund t'i drejtohet Gjykatës Komerciale-Departamenti Administratë në afat prej 30 ditësh nga data e pranimit të këtij vendimi.

Vendimi t'i dorëzohet:
1x1 AK Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural
1x1 OE "N.P.SH. "ESG" me seli në Prishtinë
1x1 Arkivës së OSHP-së;
1x1 Për publikim në ueb- faqe të OSHP-së.